Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË SHTËRPCËS PËR VITIN 2023

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2024

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

1 Opinioni i Auditimit

2 Gjetjet dhe rekomandimet

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Shtërpcës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2023, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.[1]

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Shtërpcës (KSH), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera[2], për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2023.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Shtërpcës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Shtërpcës kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

A1 Parregullsi në menaxhimin e avanceve për udhëtime zyrtare.

A2 Parregullsi në përdorimin e kartelës kreditore për udhëtime zyrtare.

B1 Komisioni i inventarizimit nuk kishte përgatitur raport për gjendjen e inventarizimit para përgatitjes së PVF-ve.

B2 Komuna nuk ka arritur të verifikojë 20% të pronës në përputhje me Ligjin për tatimin në pronë, nr. 06/L-005.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetari i Komunës është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetari i Komunës është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Shtërpcës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Shtërpcës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Shtërpcës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.[3]

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Shtërpcës me kriteret e përcaktuara te auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.

- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Shtërpcës.

- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.

- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuara me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet[4]

Gjatë auditimit kemi identifikuar fusha ku nevojiten përmirësime në menaxhimin financiar dhe kontrollin. Në veçanti, kemi identifikuar dobësi në fushën e menaxhimit të pasurive, të hyrave dhe llogarive te arkëtushme. Këto Çështje janë paraqitur në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve të mëposhtme për t'u shqyrtuar.
Rekomandimet e paraqitura më poshtë, synojnë të përmirësojnë kontrollin e brendshëm në lidhje me menaxhimin dhe kontrollin financiar, duke respektuar autoritetin që lidhet me menaxhimin e fondeve në sektorin publik. Plani ynë është të rishikojmë dhe të ndjekim këto rekomandime gjatë procesit të auditimit për vitin e ardhshëm. Raporti ynë ka rezultuar me gjashtë (6) prej të cilave katër (4) të përsëritura dhe dy (2) rekomandime të reja për përmirësimin e këtyre aspekteve të menaxhimit financiar dhe kontrolleve.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Parregullsi në menaxhimin e avanceve për udhëtime zyrtare

Gjetja

Rregullorja e QRK nr. 06/2023 për kompensimin për udhëtime zyrtare dhe shpenzime të përfaqësimit, neni 5 pika 1, thekson se; kërkesa për udhëtim zyrtar duhet të bëhet së paku pesë (5) ditë para datës së udhëtimit. Sipas Vendimit nr. 30/2018 për aprovimin e tarifave të rishikuara për udhëtimet zyrtare jashtë vendit, totali i shpenzimeve të lejuara për ditë qëndrimi, fjetja, ushqimi dhe shpenzimet e vogla (20% e shpenzimeve ditore) bazohet në tabelën llogaritëse së bashku me shpjegimet shpjeguese. Neni 4 pika 2 e kësaj rregulloreje parasheh që udhëtimi zyrtar nënkupton udhëtimin i cili ka destinacion apo qëllim që shërben për kryerjen e detyrave zyrtare në interes të Republikës së Kosovës. Rrjedhimisht, neni 6 pika 2 për llogaritjen e shpenzimeve ndërlidhet me ftesën dhe specifikon rastet kur shpenzimet janë në ngarkim tërësisht të palës pritëse, të cilët u sigurojnë zyrtarëve shpenzimet e ushqimit dhe fjetjes, pa u paguar asgjë në dorë, atëherë zyrtari përfiton nga buxheti i organizatës buxhetore të tij, shpenzime të vogla të përcaktuara në shumën 20% të shpenzimeve ditore.

Në vitin 2023,shpenzimet për udhëtime zyrtare jashtë vendit ishin 68,267€ me një rritje në raport me vitin 2022 për 51,257€ ose 301%.

Nga testimi i avanceve në vlerë prej 53,568€ të cilët përfshinin 18 udhëtime zyrtare, kemi vërejtur se:

- Për tri (3) udhëtime zyrtare mungonte formulari i kërkesës për udhëtim zyrtar me informatat mbi udhëtimin dhe aprovimin prej zyrtarëve përkatës
- Për 18 udhëtime zyrtare mungonte formulari i llogaritjes së shpenzimeve të udhëtimit zyrtar. Në lidhje me këtë, për vlerën e shpenzuar prej 12,195€ vetëm për ushqim, nuk kemi arritur të vlerësojmë se sa janë tejkaluar limitet për ushqim dhe shpenzimet e vogla;
- Për 18 udhëtime zyrtare, shpenzimet e akomodimit ishin në vlerë prej 18,150€, ndërsa në bazë të tarifave të aprovuara të shpenzimeve të fjetjes ka pasur tejkalim në vlerë prej 11,007€ apo 60.6% nga shpenzimet e lejuara;
- Në pesë (5) raste për udhëtimet e realizuara, ftesa nga organizatori nuk ndërlidhet me qëllimin e vizitës së të ftuarit;
- Në një rast, udhëtimi ishte bërë në mungesë të ftesës zyrtare. Vlera e shpenzimeve për këtë udhëtim është 420€.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mos përgjegjësisë dhe mos korrektësisë së mbajtësit të kredit kartelës, mungesës së kontrolleve efektive të brendshme si dhe neglizhencës së zyrtarëve përkatës për arsyetimin e duhur të dëshmive për mbylljen e avanceve.

Ndikimi

Mos respektimi i kërkesave ligjore në përdorimin e buxhetit për udhëtime

zyrtare, tejkalimi i limitimeve, shfrytëzimi i fondeve publike jo për qëllime zyrtare kanë ndikuar në dëmtimin e fondeve publike dhe uljen e besueshmërisë ndaj institucionit.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë që të gjitha kërkesat për udhëtime zyrtare të plotësohen dhe të miratohen paraprakisht. Po ashtu, të gjitha shpenzimet duhet të llogariten dhe të dokumentohen në formularët e përcaktuar për të shmangur tejkalimet e shpenzimeve dhe për të garantuar transparencën dhe përputhshmërinë me rregulloren për udhëtime zyrtare.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja A2 - Parregullsi në përdorimin e kartelës kreditore për udhëtime zyrtare

Gjetja Rregullorja nr. 02/2018 për përdorim të kartelës kreditore për udhëtime zyrtare, neni 7 pika 1 thekson se mbajtësi i kartelës kreditore lidh marrëveshje individuale me kontraktorin, ku pajtohet që kartelën kreditore ta përdorë sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje, dhe nga një kopje të marrëveshjes individuale i dorëzon organizatës buxhetore ku punon.
Sipas nenit 8 pika 1 thekson se mbajtësi i kartelës kreditore ka një limit të paracaktuar për kartelën kreditore, i cili propozohet nga organizata buxhetore dhe aprovohet nga Thesari, ndërsa pika 3 thekson se Limiti do të jetë në fuqi pavarësisht numrit të udhëtimeve të autorizuara gjatë çdo periudhe mujore. Me arsyetimet përkatëse Organizata buxhetore mund t'i kërkoj Thesarit ngritjen e përkohshme të limitit të kartelës kreditore, ndërsa pika 4 e këtij neni thekson se OB obligohet që pas përfundimit të udhëtimit zyrtar të paraparë në paragrafin 3 të këtij neni të bëj kërkesë në Thesar për reduktimin e limitit të kartelës kreditore në gjendjen fillestare.
Sipas nenit 9 pika 2, Organizata buxhetore pasi të ketë pranuar raportet mujore nga kontraktori, kontrollon të gjitha obligimet për t'u paguar, që i ka bërë mbajtësi i kartelës kreditore, si dhe pika 4 e këtij neni thekson se; Në rast se mbajtësi i kartelës kreditore nuk i posedon faturat që kërkohen për shpenzimet e lejuara me kartelë kreditore, që i përkasin udhëtimit zyrtar të autorizuar, zyrtarët e organizatave buxhetore mund të mbyllin avancin me arsyetimin e shpenzimeve duke u bazuar në raportin e kreditorit, deklaratën me shkrim të mbajtësit të kartelës kreditore lidhur me shpenzimin e mungesën e faturës, pas një analize të hollësishme dhe verifikimeve të nevojshme. Po ashtu,neni 10 thekson se; Në rastet kur organizata buxhetore nuk i kryen pagesat në afatin e caktuar, sipas kësaj Rregulloreje, Thesari bën pagesën nga buxheti i organizatës buxhetore te kontraktori, jo më vonë se data pesëmbëdhjetë (15) e çdo muaji ose sipas afatit të mëhershëm përcaktuar në kontratën me kontraktorin për këto shërbime. Në këtë rast, mjetet për shlyerjen e obligimeve merren nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, duke debituar kodin ekonomik përkatës të avanceve për udhëtime zyrtare.

- Gjatë auditimit, nuk kemi gjetur asnjë marrëveshje të lidhur për përdorimin e kartelës kreditore mes mbajtësit të kredit kartelës dhe kontraktorit (Banka). Kjo marrëveshje është e nevojshme për të rregulluar përdorimin e kredit kartelës gjatë udhëtimeve zyrtare dhe për monitorimin e tyre.

- Më datë 11.01.2023 është bërë kërkesa për rritje të limitit të kartelës kreditore në Thesar në 10,000€ për shkak të pjesëmarrjes në një udhëtim zyrtarë, për të cilin limiti ishte 2,500€ i cili sipas komunës nuk do të ishte i mjaftueshëm. Kërkesa për rritje të limitit është bërë për periudhën deri me 15.03.2023. Ne kemi identifikuar se pas kësaj date nuk është bërë zvogëlimi i limitit në gjendjen fillestare.

- Në shtatë (7) raste në vlerë prej 9,351€ janë bërë pagesa të ndryshme nga kartela kreditore të cilat do të duhej të realizoheshin me procedura te rregullta të shpenzimeve dhe jo përmes kartelës së kreditit. Në katër (4) raste në vlerë prej 1,011€ janë realizuar pagesa të cilat janë shpenzime jo në përputhje me qëllimin e vizitës zyrtare. Nga janari deri në korrik 2023 avancet janë mbyllur nga thesari, ndërsa nga gushti deri në fund të vitit 2023 janë mbyllur nga komuna.

Kjo ka ndodhur si rezultat i anashkalimit të procedurave për përdorimin e kartelës kreditore, si dhe mos monitorimi i rregullt i limiteve dhe shpenzimeve.

Ndikimi

Mungesa e një marrëveshjeje të nënshkruar dhe menaxhimi jo i mirë i limitit të kartelës kreditore kanë ndikuar në shpenzime të palejuara, duke rritur rrezikun e keq menaxhimit të fondeve.

Rekomandimi A2

Kryetari duhet të sigurojë një marrëveshje të qartë për përdorimin e kartelës kreditore, duke respektuar rregulla dhe procedura të detajuara për përdorimin dhe monitorimin e saj gjatë udhëtimeve zyrtare. Të gjitha kërkesat për rritjen e limitit të kartelës duhet të jenë të përcaktuara dhe të aplikohet zvogëlimi i limitit pas përfundimit të udhëtimit. Po ashtu, duhet të sigurojë që të gjitha shpenzimet të mbeten brenda limitit të lejuar dhe që çdo shpenzim mbi këtë limit të kthehet në fondet e buxhetit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

Çështja B1 - Mos inventarizimi i pasurive jo financiare

Gjetja

Sipas Rregullores me Nr. 02/2013 – Për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, neni 19 paragrafi 4.6 dhe 4.7, kërkon që “Komisioni i inventarizimit të përgatitë raportin për kryerjen e inventarizimit” si dhe komisioni është përgjegjës gjithashtu që “Hartimi i raportit të përgjithshëm në bazë të raporteve individuale të komisionit për inventarizimin e pasurive jo financiare të bëhet në kohën e përshtatshme para përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore”. Ky proces duhet ti paraprijë përgatitjes së PFV-ve.

Komisioni për inventarizim të pasurive ishte formuar me vendim të kryetarit të komunës me datë 15.05.2023, megjithatë komisioni nuk kishte përgaditur raport për gjendjen e inventarizimit të pasurive para hartimit të Pasqyrave Vjetor Financiare (PVF).

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve dhe monitorimit efikas

	të komisionit të inventarizimit nga ana e menaxhmentit.
Ndikimi	Mos përgatitja e raportit të inventarizimit brenda afatit të paraparë, ndikon që prezantimi i pasurisë në regjistrat e Komunës dhe në pasqyrat financiar vjetore të mos jetë i saktë dhe i plotë, po ashtu rrezikon humbjen apo përvetësimin e paligjshëm të pasurisë.
Rekomandimi B1	Kryetari duhet të sigurojë funksionimin e plotë të kontrolleve dhe monitorimin e komisionit të inventarizimte në menyrë që raporti inventarizimit të hartohet me kohë, respektivisht para hartimit të PVF-ve.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mos verifikimi i pasurisë me qëllim mbledhjen e të hyrave nga tatimi në pronë

Gjetja	Sipas nenit 15.2 të ligjit nr. 06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, aktivitetet inspektuese kryhen çdo vit në së paku 20% të të gjitha objekteve brenda territorit të komunës.
	Në vitin 2023, komuna shpërndau/faturoi fatura nga sistemi Protax për tatimin në pronë për 4,172 objekte, nga të cilat 76 ishin ndërtesa të reja. Komuna arriti të inspektojë (verifikojë) vetëm 350 objekte ose rreth 8%.
	Mos verifikimi i pasurisë së palujtshme/objekteve ka ndodhur për shkak të mos funksionimit të sistemit të kontrolleve të brendshëme në kuadër të aktiviteteve për verifikimin e pronave.
Ndikimi	Moskryerja e inspektimit të pasurive të paluajtshme/objekteve mund të rezultojë në informacion jo të plotë për gjendjen aktuale të pronës, të ardhura potencialisht më të ulëta të mbledhura në dobi të komunës, dhe gjithashtu mund të rezultojë në një ngarkesë tatimore joadekuate.
Rekomandimi B2	Kryetari duhet të sigurojë arritjen e verifikimit të 20% të pronave të paluajtshme në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.2.1 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 15,424,948€, pasurive jokapitale është 82,821€, si dhe e stoqeve 2,460€. Kemi testuar 70 mostra për teste substanciale në vlerë 346,009€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B3 - Menaxhim jo i duhur i pasurive

Gjetja

Sipas nenit 2.1 të Rregullores 02/2013, të gjitha organizatat buxhetore janë të obliguara që të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, ruajtjen, evidentimin dhe raportimin e pasurisë jo financiare me qëllim të menaxhimit efektiv, efikas, ekonomik dhe me qëllim të mbrojtjes së pasurisë jo financiare nga dëmtimi dhe keqpërdorimi.

Në vitin 2012, është ndërtuar spitali me një vlerë prej 1,647,157€ dhe është pranuar teknikisht më datën 31.10.2012. Pas kësaj periudhe, spitali është furnizuar me pajisje mjekësore në vlerë totale prej 1,939,409€. Megjithatë, deri më tani, spitali ende nuk është bërë funksional. Për më tepër, gjatë vitit 2023, janë kryer investime shtesë në vlerë prej 317,325€ për përmirësimin dhe rivitalizimin e objektit të spitalit, me synimin që ta bëjë funksional dhe të përdorshëm për qëllimet mjekësore.

Edhe pse spitali/objekti ende nuk është në përdorim, vlera e tij në regjistrat e pasurisë është zhvlersuar për 479,298€, ndërsa vlera e pajisjeve mjeksore për 1,497,981€.

Në regjistrin e pasurive të komunës janë të evidentuara edhe katër ndërtesa banimi në vlerë prej 2,709,045€, të përfunduara për më shumë se (8) vite më parë, e që ende nuk janë pranuar teknikisht. Ndërtesat janë dëmtuar në masë të konsiderueshme, janë ne gjendje jo funksionale dhe të pabanueshme.

Shkaqet për çështjet e sipërpërmendura burojnë që nga viti 2012, nga mos menaxhimi i duhur dhe mungesa e kontrolleve dhe përgjegjësive. Si pasojë, tani Komuna ballafaqohet me sfida të ndryshme të cilat kërkojnë kohë dhe mjete financiare.

Ndikimi

Komuna ka bërë investime të konsiderueshme në ndërtimin e spitalit dhe furnizimin me pajisje mjekësore dhe ndërtesa tjera. Megjithatë, mungesa e funksionalizimit dhe përdorimit efektiv të këtyre investimeve ka si rezultat humbjen e vlerës së investuar, investim pa kthim në shëndetësi dhe humbje financiare për komunën.

Rekomandimi B3

Kryetari duhet të sigurojë se do të angazhohet që sa më shpejt dhe brenda mundësive buxhetore ta funksionalizoj spitalin, dhe paisjet e blera deri më tani të vihen në funksion, po ashtu, të bënë përpjekje që të sigurojë fonde, ashtu që, ndërtesat e banimit social të rinovohen dhe futen sa më shpejt në përdorim.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2.2 Të arkëtueshmet

Komuna ka raportuar llogari të arkëtueshme(Ll/A) në PVF për vitin 2023 në vlerë prej 2,987.477€. Në lidhje me taksat komunale për veprimtaritë ekonomike, me Vendimin e Kuvendit nr. 01-020/08 -14482/23, Komuna i ka falur të gjithë tatimpaguesve borxhin përgjithshëm prej 225,030€, për periudhën nga 01.01.2000 deri më 31.12.2023.

Çështja B4 - Menaxhimi jo i duhur i llogarive të arkëtueshme

Gjetja	Sipas ligjit nr. 06/L-005 mbi tatimin në pronën neni 27. Nëse tatimpaguesi ose debitori nuk e ka paguar në tërësi tatimin dhe gjobën, nëse i është shqiptuar, ose detyrimet e prapambetura tatimore, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna bën njoftimin e fundit me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve të punës nga skadimi i ditës së fundit për pagesën e borxhit, me të cilën kërkohet pagesa e shumës totale të detyrimeve të prapambetura jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike nga skadimi i ditës kur supozohet se debitori ka mundur të marrë njoftimin e fundit. Në Pasqyren Vjetor Financiar për vitin 2023, komuna ka paraqitur të arkëtueshmet (LLA) në vlerë prej 2,987,477€. Kjo vlerë përbëhet nga tatimi në pronë dhe tokë. Krahasuar me një vit më parë, shuma totale e borxhit në vitin 2023 për tatimin në pronë është ulur me 8%, ndërsa borxhet e papaguara tatimore për tatimin mbi biznesin u janë falur të gjithë debitorëve tatimor me vendim të Kuvendit. Megjithatë, edhe pse shuma në vitin 2023 është zvogëluar, borxhet e papaguara janë ende të larta. Kjo ka ndodhur për shkak se Komuna nuk ka ndërmarrë hapa konkretë ligjorë apo paralajmërues për të inkurajuar tatimpaguesit të shlyejnë borxhet e tyre. Në të njëjtën kohë, kjo situatë tregon edhe për mosfunksionimin e duhur të njësive përkatëse për menaxhimin e nevojshëm të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme.
Ndikimi	Moszbatimi i mekanizmave të vendosur me ligj dhe rregullore ndikon në rritjen e vazhdueshme të LL/A, gjë që rezulton në më pak fonde për arritjen e qëllimeve dhe nxit debitorët e tjerë që të mos përmbushin detyrimet e tyre.
Rekomandimi B4	Kryetari duhet të marrë masat për të përmirësuar funksionimin e njësive përkatëse, me qëllim të sigurimit të një menaxhimi më të mirë të të hyrave dhe llogarive të arkëtueshme.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi paraqitur informacion të përmbledhur mbi burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e mjeteve dhe të hyrat e mbledhura sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final[5]	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Burimet e fondeve	**4,184,093**	**5,187,004**	**4,556,879**	**3,562,315**	**3,174,758**
Grante Qeveritare - Buxheti	3,683,340	4,262,649	4,144,435	3,042,598	3,041,858
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	14,175	4,436
Të bartura nga viti i kaluar	0	423,602	194,606	353,658	25,350
Të hyrat vetanake	500,753	500,753	217,838	151,884	99,666
Donacionet e jashtme	0	0	0	0	3,449

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,002,911.09€. Shkak i rritjes është rritja e grantit qeveritar për 579,309.90€ dhe transferimi i të hyrave vetanake nga viti paraprak për 423,602€. Në kategorinë e investimeve kapitale 328,554€, subvencioneve 71,213€, mallrave dhe shërbimeve 23,838€ dhe pagave dhe mëditjeve 579,310€.

OB në vitin 2023, ka shpenzuar 88% të buxhetit final ose 4,556,879.19€, me një rritje prej 7% krahasuar me vitin 2022. Shpjegimet për pozicionin aktual janë paraqitur hollësisht në vazhdim.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet	2021 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	**4,184,093**	**5,187,004**	**4,556,879**	**3,562,315**	**3,174,758**
Pagat dhe mëditjet	2,388,058	2,967,367	2,966,979	2,253,056	2,224,259
Mallrat dhe shërbimet	540,358	564,196	497,886	465,007	455,380
Komunalitë	97,625	97,625	70,279	73,847	72,001
Subvencionet dhe transferet	100,000	171,214	49,940	16,585	31,500
Investimet Kapitale	1,058,052	1,386,602	971,796	753,820	391,618

Shpjegimet e ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë në vazhdim:

• Buxheti final për paga dhe mëditje është 2,967,367€, për këtë kategori është shpenzuar 99,99% e buxhetit të përgjithshëm;

• Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 23,838€, kjo rritje është rezultat i të hyrave vetanake të bartura nga viti paraprak, ndërsa shpenzimet për këtë kategori ishin 568,165€ ose 86%. Nga granti qeveritar janë shpenzuar 480,444€, 74,683€ nga të hyrat vetanake dhe 13,038€ nga të hyrat e bartura nga viti paraprak;

• Buxheti final për Subvencione dhe Transfere ishte 171,213.95€, krahasuar me buxhetin fillestar është rritur për 71,213€, kjo rritje ka ardhur si rezultat i grantit qeveritar dhe të hyrave vetanake të bartura nga viti paraprak, ndërsa shpenzimet për këtë kategori janë 49,940. ose 29%, krahasuar me vitin 2022 është rritur me 10%;

• Buxheti final për investime kapitale ishte 1,386,602€, ishin shpenzuar 971,796€. Përkundër faktit se buxheti për investime kapitale është rritur në krahasim me vitin paraprak për 164,699€ ose 8%, këtë vit janë shpenzuar 70% e buxhetit apo 971,796€. 92% e buxhetit është shpenzuar nga granti qeveritar për projekte kapitale, 38% nga të hyrat vetanake dhe 49% nga të hyrat e bartura nga viti paraprak.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2023



Të hyrat e mbledhura nga Komuna e Shtërpcës në vitin 2023 ishin 343,332€. Ato kanë të bëjnë në tatimin mbi të hyrat, të hyrat nga lejet e ndërtimit, të hyrat nga veprimtaritë e biznesit, të hyrat nga regjistrimi i trashëgimisë, taksat administrative etj. Krahas këtyre të hyrave, komuna ka pranuar të hyra indirekte të inkasuara nga nivelet qendrore në shumë prej 73,515€ (gjoba në trafik 49,337€, gjoba gjyqësore 5,795€ dhe gjoba nga Agjencia e Pyjeve në shumë prej 18,383€).

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2023 Pranimet	2022 Pranimet	2021 Pranimet
Totali i të hyrave	**500,753**	**500,753**	**343,332**	**311,589**	**353,361**
Të hyrat tatimore	471,229	471,229	267,609	223,523	223,119
Të hyrat jo tatimore	29,523	29,523	75,723	88,066	130,242

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PVF-të e vitit 2022 ka rezultuar me gjashtë (6) rekomandime. OB ka përgatitur një Plan Veprimi që tregon se si të zbatohen rekomandimet e dhëna. Deri në fund të auditimit tonë të vitit 2023, dy (2) rekomandime ishin zbatuar, dhe katër (4) të tjera nuk ishin zbatuar ende, siç tregohet në grafikun 2 më poshtë. Për një përshkrim më të detajuar të rekomandimeve dhe se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën 4 (apo Tabelën e Rekomandimeve).

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak



Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2022	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë rritjen e aktiviteteve për verifikim të pronave të paluajtshme, sipas kërkesave ligjore, në mënyrë që ndryshimet eventuale të pronave të integrohen në bazën e të dhënave për të reflektuar detyrimin e saktë tatimor.		Nuk ka filluar zbatimi
2.	Të hyrat	Kryetari duhet të sigurojë që zyrtarët përgjegjës janë duke i kryer detyrat dhe përgjegjësitë në lidhje me shpërndarjen dhe dorëzimin e faturave/aktvendimeve te subjektet afariste.	Komuna nuk kishte ndërmarrë veprime për zbatimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar
3.	Pasuritë	Kryetari duhet të analizoj arsyet se pse nuk janë kryer veprimet e përcaktuara me vendim dhe të kërkoj përgjegjësi nga zyrtarët përgjegjës të emëruar që procesi i inventarizimit të kryhet me kohë, me qëllim të prezantimit të saktë dhe të drejtë në PFV.	Edhe në këtë vit gjendja është e njëjtë.	Nuk ka filluar zbatimi
4.	Pasuritë	Kryetari duhet të sigurojë se do të angazhohet që sa më shpejt dhe brenda mundësive buxhetore ta funksionalizoj spitalin, dhe paisjet e blera deri më tani të vihen në funksion, po ashtu, të bënë përpjekje që të sigurojë fonde, ashtu që, ndërtesat e banimit social të rinovohen dhe futen sa më shpejt në përdorim.	Këtë vit kemi gjendjen pothuajse të njëjtë me përjashtim të vlerës së blerjes së pajisjeve e cila ishte më e vogël.	Nuk ka filluar zbatimi
5.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të marrë masat e nevojshme për shtuar përgjegjësinë ndaj zyrtarëve përkatës për zbatimin e ligjshmërisë, në mënyrë që të rrisin arkëtimin e borxheve dhe ndalojnë rritjen e vazhdueshme të LI.A.	Nuk janë ndërmarrë veprime nga menaxhmenti, për vendosjen e mekanzimave për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme.	Nuk ka filluar zbatimi
6.	Obligimet e papaguara	Kryetari të sigurohet që të gjitha faturat paguhen brenda afatit ligjor dhe porositja e mallrave, punëve apo shërbimeve bëhet vetëm atëherë kur komuna paraprakisht i siguron fondet apo ndan mjetet buxhetore të mjaftueshme për pagesë.	Këtë vit kemi Indentifikuar një rast, që obligimi nuk është paguar brenda afatit ligjor.	I zbatuar

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme

Agron Fetiu, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm

Blerim Kabashi, Drejtor i Auditimit

Nebojsha Ristić, Udhëheqës i ekipit

Stana Dancetović, Anëtare e ekipit

Ejup Simnica, Anëtar i ekipit

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
Parregullsi në menaxhimin e avanceve për udhëtime zyrtare	Në bazë të terminologjisë ligjore dhe në përputhje me Rregulloren nr. 06/2023, parashihet që mjetet në para të gatshme (avans)i të vendosen për udhëtimet zyrtare dhe shpenzimet e përfaqësimit. Vetëm kjo pyetje nuk trajton asnjë rast të pagesës së avansit në kuptimin e përgjithshëm, por vetëm pagesat e bëra me kredit kartelë zyrtare. Prandaj, nga pikëpamja juridike, Rregullorja nuk e trajton këtë kategori shpenzimesh dhe i referohet zyrtarëve që marrin para për shpenzime zyrtare të miratuara. Në vetë Rregulloren, në asnjë nen nuk përmendet pozita e kryetarit të komunës, duke hyrë kështu në një zonë gri, ligjërisht të pacaktuar mbi bazën e së cilës është dhënë ky rekomandim dhe mendim. Vetë fjala "parregullsi" është problematike nga pikëpamja juridike, sepse sipas nesh nuk ka parregullsi, mund të thuhet se ka mangësi në procedura dhe paqartësi për mënyrën e llogaritjes së shpenzimeve dhe popullsinë e tejkalimeve që sipas mendimit tonë nuk ka pasur. Gjithashtu e konsiderojmë të panevojshme nxjerrjen në pah dhe krahasimin e shpenzimeve për vitin 2022, të cilat në interpretim përfundimtar mund të kenë konotacion të gabuar. Është thelbësisht e rëndësishme të theksohet se vetëm zyrtarët e lartë mund të kenë të drejtën e kredit kartelës zyrtare në mënyrë që vetë zyrtarët të shmangin procedurat burokratike për aktivitetet e tyre dhe të lehtësojnë procedurat logjistike për këta zyrtarë të lartë. Me fjalë të tjera, nga aspekti juridik, nëse Rregullorja 06/2023 proceduralisht i referohet, për shembull, Presidentit të Kosovës ose Kryeministrit, Ministrit apo Kryetarit të Komunës, kjo do të thoshte se nuk do të ishte e	E gjetura qendron,Rregullorja Nr 06/2023 per kompensimin per udhetime zyrtare dhe shpenzzime të përfaqesimit Neni 5, Paragrafi 6 specifikon se në rast se udhëtimi zyrtar realizohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit (në këtë rast kryetari i komunës), nevojitet miratimi i titullarit të institucionit (i cili është vetë kryetari). Kjo mund të interpretohet si një proces formal brenda administratës komunale ku miratimi formal bëhet nga një nivel më i ulët administrativ, por me autorizimin e kryetarit. Pra, kryetari i komunës është ai që duhet të miratojë kërkesat zyrtare për udhëtim, por në rastet kur ai vetë është udhëtari, mund të kërkohet një aprovim formal nga një strukturë tjetër brenda komunës ose një njoftim më i lartë.

mundur asnjë aktivitet jashtë vendit, nga vetë shpenzimet për çështjen e ftesës.

- Formulari i kërkesës ka qenë pjesë e procedurës dhe nëse nuk ekziston për ndonjë arsye, lind pyetja se kush është përgjegjës për mungesën e atij dokumenti. Nga pikëpamja ligjore, kërkesa miratohet proceduralisht nga titullari i institucionit, në këtë rast kryetari i komunës. Ky mendim i auditorit do të thotë se kryetari i komunës nuk e ka aprovuar kërkesën për udhëtim zyrtar. Përsëri jemi të mendimit se kjo procedurë nuk vlen për zyrtarët më të lartë. Një zyrtar i lartë mund të ketë marrë ftesë për takim verbalisht si pjesë e aktivitetit, sepse ata janë përfaqësuesit më të lartë të zgjedhur të qytetarëve. Imagjinoni një situatë në të cilën kryeministri, për shembull, duhet të ketë një ftesë për një udhëtim zyrtar jashtë vendit, dhe kjo është pjesë e aktiviteteve të vetë kryeministrit. Rregullorja e referuar nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm u referohet zyrtarëve të cilëve u jep miratimin drejtuesi i institucionit. Në fund, e përsërisim, vetë dokumenti i kërkesës dorëzohet dhe miratohet gjithmonë nga kryetari i komunës dhe nëse do të kontestohej proceduralisht, institucioni i Thesarit do të njoftonte Komunën dhe do të kërkonte dokumentin që mungon për të plotësuar çështjen.

2. Ne jemi të mendimit se është proceduralisht e pamundur mbyllja e çështjeve të pagesës pa vetë formularin. Është e paqartë përgjegjësia e kujt është nëse mungojnë formularët për llogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit zyrtar dhe ky është rasti i 18-të - Çfarë masash mund dhe duhet të marrë kryetari në këtë rast? Vihet re se në 7 muajt e parë ka bërë përllogaritjen Thesari, ndaj mbetet një pyetje e hapur nëse Thesari do të kishte mbyllur çështjet pa formular. Ne duam të korrigjojmë proceduralisht çdo mangësi por kjo pyetje nuk vlen për ne. Gjithashtu, konsiderojmë se nuk duhet theksuar si e tillë theksimi i shumës së shpenzuar prej 12,195 €, sepse vetë

	Zyra e Auditorit ka konstatuar se ka mangësi në formular. Llogaritjet arbitrare mund të dëmtojnë integritetin e institucionit apo individëve. Synimi i auditimit është korrigjimi i mangësive në procedura, në këtë rast pyetja është se kush duhet dhe çfarë duhet bërë për të siguruar që dokumentet të jenë të arkivuara siç duhet sepse, e përsërisim, si është e mundur mbyllja e çështjes pa formën e specifikuar?	

Parregullsi në përdorimin e kartelës kreditore për udhëtime zyrtare	Institucioni i Komunës në mënyrë procedurale ka bërë gjithçka që i është kërkuar nga vetë institucioni. Dhe në këtë rast, në një kuptim të përgjithshëm, duhet të përmendim se Thesari ka pasur një proces monitorimi dhe se në asnjë moment Komuna e Shtërpcës nuk është njoftuar për ndonjë mangësi. Vetë titulli i rekomandimit për parregullsitë në përdorimin e kartelës kreditore nuk qëndron sepse tregon ndonjë parregullsi, sipas rregullorës nr. 02/2018, për të njëjtën do të na informonte edhe Thesari. Komuna e Shtërpcës dhe mbajtësi i kartelës kreditore proceduralisht kanë bërë gjithçka ashtu siç e kërkon vetë Rregullorja, prandaj ne nuk pajtohemi në kuptimin e përgjithshëm se ka pasur ndonjë parregullsi. Në konsultim me institucionet e tjera, ne kemi marrë informata se asnjë institucion nuk ka një marrëveshje ndërmjet mbajtësit të kartelës kreditore dhe Bankës. Kjo pyetje është e paqartë sepse Marrëveshja ekziston ndërmjet Thesarit dhe Bankës. Prandaj, është e paqartë se çfarë duhet të bëjë vetë institucioni në këtë çështje, sepse ne nuk mund ta nënshkruajmë marrëveshjen. Për kë zbatohet në thelb ky rekomandim? 2. Nuk e zvogëlon kufirinKomuna e Shtërpcës e jo Thesari. Komuna nuk ka si ta bëjë këtë.Në këtë rast, pyetja thelbësore është se cilat janë rastet në fjalë, cilat janë procedurat e rregullta, cilat janë pagesat që nuk janë në përputhje me qëllimin e vizitës zyrtare? Interpretimet e këtyre pyetjeve hapin pyetje të tjera të procedurave logjistike për të mbuluar aktivitetet e zyrtarëve të lartë dhe anëtarëve të delegacionit. Në mënyrë që institucioni i Komunës të bëjë gjithçka për korrigjimin e mangësive, është nevojshëm shpejgimi i këtij konstatimi.	E gjetura qendron, Sipase Regullores Nr 02/2018 për përdorim të kartelës kreditore për udhëtime zyrtare neni 7 mavveshjet për perdorimin e kartelës kreditore pika 1 mbajtesi karteles kreditore lidhe marrveshje individuale me kontraktorin.

Potvrdno pismo

	3. Jemi të mendimit se përllogaritja e shpenzimeve është bërë në atë mënyrë që ka marrë parasysh Rregulloren 06/2023, të cilën e kemi shkruar tashmë se ligjërisht i referohet avansit në para të gatshme, jo shpenzimeve të paguara me kartelën kreditore zyrtare. Është më e rëndësishme të thuhet se ka fatura të duhura për të gjitha shpenzimet, në mënyrë që të mos ketë asnjë pagesë të vetme pa faturë për të. Çmimet e akomodimit nuk përcaktohen nga vetë zyrtari, dhe vetë çmimet e akomodimit ndryshojnë dhe nuk janë asnjëherë fikse. Përsëri, i kthehemi komentit në fillim dhe pyetjes nëse Rregullorja 06/2023 vlen për zyrtarët e lartë? Ne e konsiderojmë arbitrare të shkruajmë se ka pasur një tejkalim sepse ka një mosmarrëveshje të qartë me popullsinë ligjore nëse referenca në Rregulloren 06/2023 dhe llogaritjet e bëra në bazë të tabelës zbatohen edhe për pagesat me kartelë kreditore. Hipotetikisht, në bazë të së njëjtës Rregullore, në nenin 10, pika 3, thuhet se punonjësi do të rimbursohet për shpenzimet e pambuluara dhe të arsyetuara. Me fjalë të tjera, një punonjës që merr avans në para sipas tabelës së kësaj Rregulloreje 06/2023, për çdo llogari që paguan për shpenzime të pambuluara nga paratë e gatshme që ka marrë, duhet të rimbursohen të gjitha shpenzimet. Prandaj, në një situatë kur këto shpenzime nuk paguheshin me kartelë kreditore, e drejta e kompensimit sigurisht që do të ekzistonte proceduralisht dhe bazuar në çmimet e akomodimit të vetë hoteleve.Besojmë se nuk ka tejkalime sepse nuk ka pasur shpenzime të paarsyetuara, ka faturë për çdo pagesë.	

	4. Çdo ftesë për një zyrtar të lartë, edhe pse e përsërisim se është e panevojshme për mendimin tonë, i është dërguar emrit dhe mbiemrit. Pyetja teknike është se si trajtohet qëllimi i veprimtarisë zyrtare të një zyrtari të lartë, prandaj këtu shtrohet çështja e interpretimit, e cila në rastin e një zyrtari të lartë mund të interpretohet edhe mbi baza politike? Shtrohet pyetja se cila është baza e këtij mendimi, sepse njëra është kur ke aktivitetin e një zyrtari dhe tjetra është kur bëhet fjalë për aktivitetet e zyrtarëve më të lartë. 5.Nuk është e qartë se për cilin udhëtim bëhet fjalë? Përsëri, lindin çështje procedurale në mënyrë që vetë institucioni të kuptojë pjesën e tij të përgjegjësisë dhe të ndërmarrë hapa për të siguruar që dokumentacioni i çështjes të jetë i plotë. Ju lutemi keni parasysh se në çdo raport të kryetarit të komunës në fund të muajit, thuhet qartë se drejtuesi i institucionit njoftohet proceduralisht për çdo mangësi apo pyetje të hapur. E përmendim edhe një herë se vetë Thesari i mbylli rastet dhe se nuk ka pasur vërejtje apo pyetje lidhur me këtë dhe të gjitha çështjet e tjera të mëparshme.	

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2023 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Shtërpcës, për vitin 2023 (në tekstin e mëtejmë "Raporti");
- pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet dhe në të njëjtën kohë ju dërgoj komente në lidhje me përmbajtjen e raportit
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Dalibor Jevtić

Kryetar I Komunës Shtërpcës,

Data: 20.06.2024, Shtërpcë

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare[6] duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet[7], duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)
Forma e opinionit

Opinioni i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinioni i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinioni

Opinioni i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financave;

b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose

c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin ‘theksim i çështjes’ ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç’pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinioni i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

[1] Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikat e mira relevante në sektorin publik

[2] Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar

[3] Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet

[4] Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

[5] Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

[6] Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit

[7] Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikat e mira.